

Gjykata e Apelit Vlorë, në dt. 18 mars 2022, paraqiti raportin vjetor për veprimtarinë e saj gjatë vitit 2021. Fokusi kryesor i këtij raporti ishte pasqyrimi i ecures së vendimmarrjes gjatë një viti mjaft dinamik përse i përket problematikave serioze, që kanë rezultuar me zvogëlimin më tepër se ½ të përbërjes së trupës gjyqësore të kësaj Gjykate për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve dhe numrit gjithmonë në rritje të çështjeve të regjistruara pranë kësaj gjykate.

Në këto rrethana, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit janë vendosur para një sfide të rëndësishme për koordinimin e masave organizative dhe institucionale në funksion të rritjes së efektivitetit të vendimmarrjes së kësaj Gjykate, pasi duke përlllogaritur numrin e çështjeve të gjykuara, rezulton se për vitin 2021, secili nga gjyqtarët në detyrë, mesatarisht ka gjykuar rreth 479 çështje. Përgjatë vitit 2021 evidentohet një rritje e theksuar e numrit të çështjeve të regjistruara, 7105 në total, që në raport me vitin paraardhës është 1508 çështje më shumë.

Pavarësisht ngarkesës, gjykimi i një numri prej 2871 çështjesh në total ka qënë një sfidë e rëndësishme për Gjykatën e Apelit Vlorë. Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon se kjo gjykatë ka qënë e aftë të zgjidhë më shumë se ¾ e çështjeve të regjistruara për shqyrtim në vitin 2021.

Referuar statistikave vihet re një prirje e dukshme në rritje e vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjatë vitit 2021 janë gjykuar 710 më shumë çështje se në vitin 2020. Kombinimi i parimit të shqyrtimit kronologjik (referuar kohës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit), me parimin e përparësisë (emergjencës), sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me gjykimin me procedurë të përshpejtuar të çështjeve gjyqësore, po tregon efektet e veta.

Gjykata e Apelit ka treguar angazhimin maksimal për të shfrytëzuar çdo mekanizëm dhe metodë efektive me qëllim arritjen e një rezultati të prekshëm, të dukshëm në uljen e stokut të çështjeve me vjetërsi në pritje për gjykim, ku nga statistikatat rezulton se nuk ka asnjë çështje në pritje për gjykim nga 3-5 vjet dhe asnjë mbi pesë vjet.

Në raportin e analizës është theksuar nevoja për funksionimin e njësisë së ndihmësive ligjorë, me qëllim përpunimin e sa më shumë çështjeve për vendimmarrje, pavarësisht numrit aktual të gjyqtarëve të kësaj Gjykate, strukturë kjo që sigurisht do të prodhojë efekte pozitive në veprimtarinë e saj edhe përse i përket përmirësimit të efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore që i ofrohen publikut.

Rikthimi i besimit tek drejtësia mbetet një sfidë për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, ashtu si për të gjithë sistemin e drejtësisë dhe për këtë arsye, të gjithë gjyqtarët dhe stafi administrativ janë të angazhuar të kontribuojnë edhe në vijim.

Ju ftojme të lexoni gjetjet në Analizën e Veprimtarisë Vjetore 2021 të Gjykatës së Apelit Vlorë.